

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit R. B. H. nga P., rr. "...” pnr., për shkak se ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë PP.nr.1439-13/2009 të dt.24.04.2009, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e Prokurorit të shtetit Valdet Gashi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të dëmtuarit A. H., mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare Avokati R. F. si dhe të pandehurit R. H., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor gjykata më dt.07.03.2014, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri: **R. H.**, nga i ati B. dhe e ëma R. e vajzërisë Q., i lindur më dt.*data e lindjes...* në fshatin B., Komuna e P., tani me vendbanim në P., rr. "....” pnr., i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në paraburgim nga data 07.03.2014 e tutje.**

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### Sepse:

Me qëllim me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasurorë të kundërligjshëm, më dt.10.03.2008, në intervalin kohor prej orës 17:30 deri 23:50, fshatin B., KK P., i pandehuri ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit A. H. dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm të pidentifikuar ka hapur dritaren e kuzhinës, ka depërtuar brenda, është ngjitur në katin e epërm dhe në dhomën e fjetjes ka vjedhur një kasafortë të metalit në të cilën gjendeshin stoli të ndryshme ari në vlerë rreth 2000 euro, dhe është larguar nga vendi i ngjarjes,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 6, 11, 34, 38, 64 dhe 73 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e :

### G J Y K O N

**I. Të akuzuarit R. H.**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) vitesh**, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II.** Pas shpalljes së aktgjykimit të akuzuarit në kuptim të nenit 367 par.1 nën par.1.1 lidhur me par.3 dhe par.7 të KPPRK-së, i caktohet masa e paraburgimit prej datës **07.03.2014** deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykim.

**III.** Konform nenit 73 par.1 të KPK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **23.04.2009 deri më 23.05.2009**

**IV.** Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **150 Euro** (njëqindpesëdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**V.** I dëmtuari A. H. nga fshati B., Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë me aktakuzën PP.nr.1439-13/2009 të dt.24.04.2009, ka akuzuar të pandehurin R. B. H. nga P., rr. “...” pnr., për shkak se ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt.07.03.2014 në të cilën u dëgjuan Prokurori i shtetit Valdet Gashi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i dëmtuari A. H., mbrojtësi i të pandehurit i caktuar sipas detyrës zyrtare avokati R. F. si dhe i pandehuri R. H..

Prokurori i shtetit **Valdet Gashi**, në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës të ngritur kundër të pandehurit R. H. me PP.nr.1439-13/2009 e dt.24.04.2009, për faktin se e njëjta është e mbështetur në prova të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri i lartcekur e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale u vërtetua edhe sot në këtë seancë sidomos pas administrimit të provave konkretisht mendimit të ekspertit të daktiloskopisë me nr. 08-733 -FS, i dt. 01.04.2009, ku është ekzaminimi se gjurmët e vijave papilare të gjetura në vendin e ngjarjes me shifrat D3 A, D 4 A, dhe D 5 A, përputhen me gishtat e të pandehurit, ndërsa pretendimet e të akuzuarit se nuk ka qene në vendin e ngjarjes në kohën kur është kryer vepra penale, vlerësojmë se janë tentim i tij për t'i ikur përgjegjësisë penale nga se është në kundërshtim të plotë me provat materiale të administruara në këtë seancë konkretisht mendimin e ekspertit të daktiloskopisë. Andaj mendoj se në këtë seancë është vërtetuar dyshimi i bazuar se ky është kryes i kësaj veprë penale dhe për këtë kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpalli fajtor dhe ta dënoj sipas Kodit Penal dhe me rastin e matjes së dënimit ta merr parasysh si rrethanë rënduese faktin se i njëjti është recidivist i veprave të shumta penale konkretisht vjedhjes së rënd.

I dëmtuari **A. H.** në shqyrtimin gjyqësor dhe fjalën përfundimtare deklaroi se R. H. kishte hyrë në shtëpinë e tij në ditën kritike pasi atë ditë unë isha të vëllau i tij që unë e

kam dhëndër ndërsa kërkesën pasurore juridike ndaj të pandehurit do ta paraqes në kontest civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. H. avokati **R. F.** në fjalën përfundimtare deklaroi se pasi që i mbrojtur im nuk e ka pranuar veprën penale, mendojë se me asnjë prove nuk është vërtetuar fajësia e tij, për çka i kisha propozuar gjykatës që në vështrim të nenit 364 te KPPK-se, ta lirojë nga aktakuza ose nëse gjykata gjen se ka elemente të veprës penale Vjedhje e rënd nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-se, të aplikoj dispozitat e nenit 73,74,75 dhe ndaj klientit tim ta zbuti dënimin ose eventualisht ti shqiptoj një dënim të kushtëzuar, ndërsa sa i përket raportit të ekspertit të daktiloskopisë e kundërshtojmë në kuptim të mbrojtjes.

I akuzuari **R. H.** në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor e mohoj kryerjen e veprës penale, kurse gjurmët e gishtrinjëve të gjetura në vendin e ngjarjes nuk janë të miat por janë montim i policisë ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se e përkrahi ne tërësi fjalën e mbrojtësit tim dhe sa i përket këtij rasti e ndiej veten të pa fajshëm dhe kërkoj nga gjykata që të me lirojë nga akuza.

Pas administrimit të provave, vlerësimit dhe krahasimit të tyre, gjykata në mbështetje të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e tillë faktike si në dispozitiv të aktgjykimit gjykata e vërtetoi nga këto prova: nga Raporti i ekspertit të daktiloskopisë nr.08-733-FS, i datës 01.04.2009, nga fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës si dhe nga deklarata e të dëmtuarit A. H..

Nga Raporti i ekspertit të daktiloskopisë nr.08-733-FS, i datës 01.04.2009i kryer në Laboratorin Qendror të Kriminalistikës gjurmët e vijave papilare të gjetura në vendin e ngjarjes pas krahasimit në Sistemin AFIS kanë dhënë identitetin (përputhen) :

**D3a**- ka dhënë identitetin (përputhet) me gishtin **Nr.4** (gishti i unazës i dorës së djathtë) i personit R. H. i lindur më *data e lindjes...* .

**D4a** – ka dhënë identitetin (përputhet) me gishtin **Nr.8** (gishti i mesëm i dorës së majtë) i personit R. H. i lindur më *data e lindjes...*

**D5a**- ka dhënë identitetin (përputhet) me gishtin **Nr.2** (gishti tregues i dorës së djathtë) i personit R. H. i lindur më *data e lindjes...* , vërtetohet fakti se i akuzuari R. H. i lindur më *data e lindjes...* është kryes i veprës penale.

Nga foto dokumentacioni i shkresave të lëndës me rastin e identifikimit të vendit të ngjarjes, vërtetohet fakti se në shtëpinë në të cilën është kryer vjedhja është depërtuar në brendi të saj me mjete të përshtatshme duke përdorur forcën, me ç'rast janë demoluar orenditë në të cilat kanë qenë sendet e vjedhura.

Nga deklarata e të dëmtuarit A. H. gjykata vërtetoi se më dt.10.03.2008, në shtëpinë e tij në fshatin B., KK P., me përdorimin e forcës është depërtuar në brendi ku

janë vjedhur gjësende të ndryshme - stoli ari, derisa ai ishte për vizitë tek dhëndri i tij në P. gjegjësisht vëllai i R. H. .

Nga provat e administruara gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit R. H. formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje e rëndë nga 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Gjykata ia fali besimin deklaratës së të dëmtuarit A. H., pasi që deklarata e tij përputhet në tërësi edhe me mendimin e ekspertit të daktiloskopisë të dhënë në raportin nr.08-733-FS, i datës 01.04.2009, sipas të cilit gjurmët e gishtërinjve të gjetura në vendin e ngjarjes përputhen në tërësi me gjurmët e gishtërinjve të të akuzuarit R. H..

Sipas vlerësimit të gjykatës mbrojtja e të akuzuarit R. H. është e orientuar kah ikja ndaj përgjegjësisë penale duke e mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ia fali besimin deklaratimit të tij se ai në intervalin kohor prej orës 17:30 deri në 23:50 ishte tek teza e tij N. G. në F. K. ngase as ai e as mbrojtësi tij asnjëherë nuk kanë propozuar që ajo të dëgjohet në cilësinë e dëshmitares, gjithashtu deklaratimit të të pandehurit se gjurmët e gishtrinjëve të gjetura në vendin e ngjarjes janë vetëm montim i policisë gjykata nuk ia fali besimin sepse ky deklarim nuk ka mbështetje në asnjë provë të vetme, për këtë gjykata gjeti se i akuzuari është përgjegjës për veprimet penale për të cilën është shpallur fajtor.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 64 të KPK-së ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë lehtësuese mori gjendjen e tij të dobët ekonomiko-sociale, ndërsa si rrethanë rënduese mori se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër penale Vjedhje e rëndë, se ndaj tij zhvillohet procedurë penale për vepra penale Vjedhje e rëndë, është recidivist, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, motivin për kryerjen e veprës, shkallën e rrezikimit apo dëmtimit të së mirës së mbrojtur, andaj të njëjtin e gjykoji si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë të të akuzuarit , dhe se me këtë dënim do të bëhet risocializimi i tij dhe se do të jetë si preventivë për të dhe të tjerët të mos kryejnë vepra penale të tilla apo të ngjashme, e që është qëllimi i dënimit nga neni 34 i KPK-së.

Vendimi që të akuzuarit në dënimin e shqiptuar ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim u mor në kuptim të dispozitave të nenit 73 par.1 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi që të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit t'i caktohet paraburgimi u mor konform nenit 367 par.1 nën par.1.1 lidhur me par.3 dhe par.7 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**P.nr.1710/2012 më dt.07.03.2014**

**Sekretarja juridike:**  
**Fatmire Podvorica**

**Gjyqtari :**  
**Minir Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.